



**BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 34, datë 23.05.2016

Për

**“DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 59, DATË 30.12.2015,
“PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË QYTETIN E TIRANËS” (i
ndryshuar)”**

Në mbështetje nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.3, shkronja “b”, nenit 34, pika 6, nenit 35, pika 4 dhe nenit 54, shkronja “f” të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”; nenit 5, shkronja “a” të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar); nenit 128 të ligjit nr.8485, datë 12.05.1999, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.59, datë 30.12.2015, “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës” (i ndryshuar), pas shqyrtimit të relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë ndryshimet në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.59, datë 30.12.2015 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”, i ndryshuar, si vijon:

i. Në Pikën I.a.1, ”Taksa mbi ndërtesën”, pas paragrafit të fundit shtohen paragrafët si më poshtë:

“Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi ndërtesat për kategorinë I “Ndërtesa Banimi”, kategorinë III “Ndërtesa më shumë se një banesë” dhe kategorinë IV “Ndërtesa në pronësi apo në përdorim, në territore të miratuara si fshatra turistike” të përdorura për qëllim banimi, të cilat nuk kanë një kontratë shërbimi për furnizimin me ujë të pishëm me UKT Sh.A., është Njësia/të Administrative deri në lidhjen e kësaj kontrate. Ndërsa, struktura e ngarkuar për arkëtimin dhe raportimin e tyre është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, sipas procedurës/ve të përcaktuara nga Kryetari i Bashkisë.

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e detyrimeve të papaguara deri më 31.12.2015, nga taksa mbi pasuritë e paluajtshme për kategorinë I “Ndërtesa banimi”, kategorinë III “Ndërtesa më shumë se një banesë” dhe kategorinë IV “Ndërtesa në pronësi apo në përdorim, në territore të miratuara si fshatra turistike” të përdorura për qëllim banimi është Njësia/të Administrative, ndërsa struktura e ngarkuar për arkëtimin dhe

raportimin e tyre është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, sipas procedurës/ve të përcaktuara nga Kryetari i Bashkisë.”

- ii. Në Pikën I.a.2, ”Taksa mbi tokën bujqësore”, pas paragrafit të fundit shtohen paragrafët si më poshtë:

“Struktura e ngarkuar për mbledhjen e detyrimeve të papaguara deri më 31.12.2015 për taksën mbi tokën bujqësore është Njësia/të Administrative, ndërsa struktura e ngarkuar për arkëtimin dhe raportimin e tyre është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, sipas procedurës/ve të përcaktuara nga Kryetari i Bashkisë.”

- iii. Në Pikën I.c “Taksa e Fjetjes në Hotel” paragrafi i parë, fjalia e parë, ndryshon si më poshtë:

“Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara ne hotel”.

- iv. Në Pikën I.c “Taksa e Fjetjes në Hotel” pas paragrafit të tretë shtohet:

“Taksa e fjetjes në hotel, deri në vendosjen e sistemit të klasifikimit të hoteleve dhe strukturave akomoduese në vend, sipas nenit 45 të ligjit nr.93/2015, datë 27.07.2015 për “Turizmin” do të jetë:

- a. *350 lekë për njësi dhomë/natë për hotelet Rogner, Sheraton Tirana dhe Hotel Tirana Internacional; dhe*
- b. *140 lekë për njësi dhomë/natë për të gjithë hotelet e tjerë, bujtinat, fjetinat, motelet dhe çdo njësitë tjetër akomoduese.*

Për kategorinë e subjekteve të cilat deklarojnë me orë pushimi deklarimi deri në tre pushime në ditë të konsiderohet i barazvlefshëm me një natë fjetje”.

- v. Në Pikën I.d (1) “Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga Ndërtimet e Reja” fjalia e parë ndryshon si më poshtë:

“Në rastin e ndërtimeve për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik, taksa e ndikimit në infrastrukturë është në masën 8 për qind të çmimit të shitjes për metër katror të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.”.

- vi. Në Pikën I.d (2) “Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga Ndërtimet e Reja” ndryshohet si më poshtë:

“Në rastin e ndërtimeve të ndryshme, niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtime të reja është 4 për qind e vlerës së investimit. Vlera e investimi llogaritet sipas kostos mesatare të ndërtimit të banesave të miratuar nga Enti Kombëtar i Banesave ose preventivin e investimit të paraqitur nga subjekti i interesuar dhe përzgjidhet vlerën më të lartë midis të dyjave.”.

- vii. Pas Pikës I.d (2) “Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga Ndërtimet e Reja” shtohet pika (2/1) më poshtë:

“Në rastin e ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën I.d (1), për funksione publike me investime dhe/ose grante që i jepen institucioneve shtetërore, niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtime të reja është 2 për qind e vlerës së investimit. Vlera e investimi llogaritet sipas kostos mesatare të ndërtimit të banesave të miratuar nga Enti Kombëtar i Banesave.”.

- viii. Pikën I.d (4) “Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga Ndërtimet e Reja” shtohet fjalia:

“Vlera e investimi llogaritet sipas kostos mesatare të ndërtimit të banesave të miratuar nga Enti Kombëtar i Banesave”.

- ix. Në Pikën I.d “Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga Ndërtimet e Reja” pas paragrafit të fundit shtohet paragrafi si më poshtë:

“Struktura e ngarkuar për përlllogaritjen dhe arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtesat në proces legalizimi është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore.

“Taksa paguhet nga individi/subjekti i interesuar në çdo moment dhe gjithësesi jo më vonë se 45 ditë nga data e dhënies së lejes së legalizimit nga ALUIZN (Agjencia e Legalizimit, Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale). Nëse subjekti/personi i interesuar nuk kryen pagesën brenda këtij afati, atëherë për çdo ditë vonesë i llogaritet kamatë 0,1 për qind në ditë e shumës që duhet të paguajë, deri në 30 ditë pune”.

- x. Në Pikën I.e “Taksa e Tabelës”, pas tabelës së kategorizimit të taksës, shtohet paragrafi si më poshtë:

“Lehtësia dhe përjashtime:

Përjashtimisht për bizneset e krijuara të reja, afati i pagesës së detyrimit është brenda 3 muajve nga data e rregjistrimit pranë QKR.”.

- xi. Në Pikën II.a “Tarifa e Pastrimit”, në fund të seksionit “Mënyra e pagesës”, pas paragrafit të gjashtë shtohet paragrafi si më poshtë:

“Përjashtimisht për bizneset e krijuara të reja, afati i pagesës së detyrimit është brenda 3 muajve nga data e rregjistrimit pranë QKR.”.

- xii. Në Pikën I.f “Taksa e përkohshme e infrastrukturës arsimore” dhe Pikën II.a “Tarifa për Pastrimit”, seksioni “Lehtësira dhe Përjashtime”, ndryshon si më poshtë:

“Kategoritë e përjashtuara nga pagesa e taksës së përkohshme e infrastrukturës arsimore, ku përfshihen pensionistët, veteranët, invalidët e punës e luftës, përfituesit e ndihmës ekonomike, të verbërit, të sëmurët tetraplegjik dhe paraplegjikë, si dhe personat e tjerë me aftësi të kufizuar sipas përkufizimit të Ligjit 93/2014 datë 24.07.2014 për të mundësuar këtë përjashtim, duhet të dorëzojnë pranë zyrave të Njërive Administrative të Bashkisë së Tiranës, dëshminë e gjendjes së tyre dhe konkretisht:

- Dokumentin që vërteton kushtin që të jenë kryefamiljarë dhe pa persona të tjerë madhorë përveç bashkëshortit ose bashkëshortes, në certifikatën familjare.
- Librezën e veteranit ose invalidit të luftës, statusin e invalidit të punës e të luftës, statusin e të verbërit, të sëmurëve paraplegjik e tetraplegjik, librezën e pensionit, vërtetimin e KMCA, vërtetimin nga Njësia Administrative për përfituesit e ndihmës ekonomike.”.

xiii. Tabela në Pikën II.d “Tarifa e Shërbimit Veterinar” ndryshon si më poshtë:

	Kategoritë e aktiviteteve të kontrollit	Kontrolli	Bwhet Tarifa e përcaktuar
1	Kontrolli i mishit dhe pajisja me raport veterinar për kre gjedh i rritur, gjedh i ri, (lopë, ka, mëshqerrë, viç	<ul style="list-style-type: none"> - Vizitimi para therjes. (gjëndja shëndetësore e kafshës së gjallë) - Kontrolli gjatë dhe pas therjes. (egzaminim dhe vlerësim organo-leptik i karkases). - Vulosja, plotësimi i dokumentacionit veterinar 	200 lekë (për çdo kre)
2	Kontrolli i mishit dhe pajisja me raport veterinar për një kre bagëti të imta (dash, dele, çjap, dhi, derr, rurza, milorë, ftuja, tujakë, qingj, kec, gic).	<ul style="list-style-type: none"> - Vizitimi para therjes. (gjëndja shëndetësore e kafshës së gjallë) - Kontrolli gjatë dhe pas therjes. (egzaminim e vlerësim organo-leptik i karkasës) - Vulosja, plotësimi i dokumentacionit veterinar 	200 lekë (për çdo kre)
3	Shërbim veterinar në tregun e gjësë së gjallë	<ul style="list-style-type: none"> - Rregjistrimi i dokumentacionit shoqërues për çdo bagëti të gjallë. - Lëshimi i certifikatës për lëvizjen e kafshëve 	200 lekë (për çdo kre)
	Kontrolli i mishit dhe pajisja me raport veterinar shpendë	<ul style="list-style-type: none"> - Vizitimi para therjes. - Kontrolli gjatë dhe pas therjes. -Vulosja, plotësimi i dokumentacionit veterinar 	10 lekë/100 shpend

xiv. Në Pikën II.d “Tarifa e Shërbimit Veterinar”, pas paragrafi të fundit shtohet:

“Lehtësira:

Për Kategorinë 1, për thertoret e organizuara në komplekse , ku theren mbi 100 krerë në muaj, niveli i tarifës të jetë 100 lekë/kre.

Për Kategorinë 2, për thertoret e organizuara në komplekse , ku theren mbi 100 krerë në muaj, niveli i tarifës të jetë 50 lekë/kre.”.

xv. Pika II.dh.1, “Tarifë për shqyrtimin e kërkesave për leje për kryerje punimesh” paragrafi i dytë ndryshon si më poshtë:

“Për leje zhvillimi tarifa llogaritet në bazë të sipërfaqes së zonës që do të zhvillohet. Niveli i tarifës është në vlerën 10 (dhjetë leke) për metër katror dhe depozitohet për llogari të Bashkisë Tiranë.

Për leje ndërtimi tarifa është në vlerën 1 për qind e vlerës së investimit. Vlera e investimit llogaritet sipas kostos mesatare të ndërtimit të banesave të miratuar nga Enti Kombëtar i Banesave ose preventivin e investimit të paraqitur nga subjekti i interesuar dhe përzgjidhet vlerën më të lartë midis të dyjave”.

- xvi. Në Pikën II.e.5 “Tarifa për Qendrën Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve”, pas paragrafit të dytë shtohet paragrafi si më poshtë:

“Për fëmijët e regjistruar për herë të parë kryhet një pagesë paraprake, në formën e garancisë, sa vlera e ushqimit për një muaj frekuentimi. Kjo shumë i rikthehet familjeve me përfundimin e periudhës së trajtimit në këto institucione dhe verifikimit se nuk kanë detyrime të papaguara.”.

- xvii. Në Pikën 2 pas fjalisë së parë shohet fjalia si mëposhtë:

“Ngarkohet Kryetari i Bashkisë të përcaktojë rregullat e raportimit, evidentimit dhe monitorimit të procesit të vjeljes dhe arkëketimit të taksave dhe tarifave vendore nga institucionet përgjegjëse sipas këtij vendim.”.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Njësitë Administrative, Institucionet dhe Ndërmarrjet e Varësisë së Bashkisë së Tiranës.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR

ALDRIN DALIPI
